



Drejtuar: **Operatori Ekonomik “ERZENI/SH” shpk**
Adresa: **Lagjia Bahçallëk, Rr. Nacionale, Shkodër – Tiranë, nr.pasurie 17/190, zona kadastrale 8591, Shkodër**

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur, “Furnizim me Paisje dhe Orendi për çerdhe, kopshte dhe shkolla, për vitin 2019”, Loti I-rë ”Paisje dhe Orendi për kopshte dhe çerdhe”.

Referenca e procedures: REF-24668-05 – 30 -2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: ”Paisje dhe Orendi për kopshte dhe çerdhe”.

Fondi limit, Loti I: 49.998.612 (dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) **lekë pa TVSH**

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr. 159 datë 21.12.2018 për ”Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019 - 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashksë së Tiranës për vitin 2019” (i ndryshuar), konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë

Kohëzgjatja e kontratës: Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor ekzekutimi i kontrates do të kryhet brenda 2 (dy) muajve nga data e lidhjes së saj.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 24.06.2019 Ora: 11:00.

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 22 datë 03 Qershor 2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Operatori Ekonomik “M.LEZHA” shpk

NUIS- J76504013C

Vlera e ofertës pa TVSH= **49,774,660** (dyzet e nëntë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) **lekë**

2.Operatori Ekonomik “Erzeni ” shpk

NUIS- J66902027T.

Vlera e ofertës pa TVSH është = **49,218,920** (dyzet e nëntë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) **lekë**.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “M.LEZHA” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Operatori ekonomik “**M.LEZHA**” shpk nuk plotëson pikën 2.13 të Kapacitetit Teknik të DST: *Operatori Ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 2 (dy) mjete transporti me kapacitet mbajtes nga 1 ton deri ne 3.5 ton per secilin mjet* pasi OE ka deklaruar (1) kamion me targë SH 2913E, i cili pas verifikimit të dokumentacionit rezulton se tonazhi I tij është me i madh se ai që ka kërkuar në DST.

Pra, Operatori Ekonomik “M.LEZHA” shpk, nuk plotëson “Kriteret e veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti teknik/ pika 2.13.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë**, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “Erzeni ” shpk** me adresë: Lagjia Bahçallëk, Rr. Nacionale, Shkodër - Tiranë, nr.pasurie 17/190, zona kadastrale 8591, Shkodër, se oferta paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH = **49,218,920** (dyzet e nëntë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) **lekë**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi “Skënderbej”, nr.1,

1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 28.06.2019

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesmarrëse në këtë procedure prokurimi në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi.